



Prishtinë, 27 gusht 2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1270\_2020

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

#### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtitshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastradastrave Nr. 00260-4 ZK Orize, Gjakovë, me kapacitet të instaluar prej **10.85 kW** në Komunën e Gjakovës, të datës 01.07.2020 të aplikuesit "D&Z" SH.P.K., me adresë: fshati "Meje", Komuna Gjakovë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 27 gusht 2020 nxori këtë:

### V E N D I M

#### PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "D&Z" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin e ndërtuar sipas Lejes së Legalizimit Aktvendimi nr. 07-351-3415 i dt. 21.10.2019 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit, në parcelën ngastradastrave Nr. 00260-4 ZK Orize Gjakovë, me kapacitet të instaluar prej **10.85 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Gjakovës.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "D&Z" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DGJ- 9023607 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtoj kërkesë në KEDS SH.A., për pranimit teknik të objektit energjetik.



III. ZRRE do të konsiderojë projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.

IV. Aplikuesi "D&Z" SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

### Arsyetim

- ZRRE, me datë 01.07.2020 nga aplikuesi "D&Z" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 00260-4 ZK Orize Gjakovë, me kapacitet të instaluar prej **10.85 kW** shifra e konsumatorit DGJ- 9023607 që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Gjakovës.
  - Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 4672 të datës 29.06.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Përgjigjes Nr. 07-350/01-13383 të datës 01.07.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjakovës.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "D&Z" SH.P.K., dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin parcelën ngastrave kadastrave Nr. 00260-4 ZK Orize Gjakovë, me kapacitet të instaluar prej **10.85 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Gjakovës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

